

Sigma Vienna Insurance Group SH.A.

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

Përmbajtja

Raporti i audituesit të pavarur.....	i
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërshirëse.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
1. Informacion i përgjithshëm	5
2. Bazat e përgatitjes	5
3. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël	13
4. Administrimi i rrezikut financiar.....	14
5. Administrimi i rrezikut të veprimtarisë së sigurimit.....	19
6. Administrimi i rrezikut të kapitalit	23
7. Paraqitja me vlerën e drejtë	24
8. Aktive afatgjata materiale.....	26
9. Aktive afatgjata jo-materiale	27
10. Pasuri e investuar	27
11. Aktive më të drejtë përdorimi dhe detyrimet e qirasë	27
12. Investime në sipërmarrje të përbashkëta	28
13. Aktive të risigurimit.....	29
14. Investime në letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizuar.....	29
15. Depozita me afat.....	29
16. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	30
17. Llogari të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	30
18. Aktive të tjera	31
19. Mjete monetare, ekuivalentë të tyre dhe kufizimet përkatëse	32
20. Kapitali aksionar.....	32
21. Rezerva të tjera.....	32
22. Rezerva teknike të sigurimit	33
23. Detyrime tatimore dhe të tjera	33
24. Depozita e risiguruesit.....	33
25. Detyrime nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	34
26. Prime të shkruara bruto.....	34
27. Rezerva për primin e pafituar.....	34
28. Prime të shkruara ceduar risiguruesit.....	34
29. Komisionet e risigurimit	35
30. Të ardhura nga investimet.....	35
31. Shpenzimet e marrjes në sigurim.....	35
32. Shpenzime administrative	35
33. Shpenzime të tjera sigurimi	36
34. Fitim/(humbje) nga kursi i këmbimit.....	36
35. Shpenzime financiare.....	36
36. Tatim fitimi.....	36
37. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara	37
38. Palët e lidhura	38

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Sigma Vienna Insurance Group SH.A.:

Opinionin ynë me rezervë

Sipas opinionit tonë, përveç efektit të çështjes së përshkruar në seksionin e bazave për opinionin me rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur të Sigma Vienna Insurance Group SH.A. ("Shoqëria") për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, sipas politikave kontabël të përshkruara në shënimin shpjegues 2 të pasqyrave financiare.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2023;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politika domethënëse kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin me rezervë

Rezervat teknike të sigurimit në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë përfshijnë rezerva për dëmet e ndodhura por të pa raportuara ("IBNR") për linjën e biznesit të sigurimit të pasurisë në shumën 278,566 mijë Lekë më 31 Dhjetor 2023 dhe 253,628 mijë Lekë më 31 Dhjetor 2022. Mbulimi përkatës nga risiguruesi në aktivet e risigurimit është 12,765 mijë Lekë më 31 Dhjetor 2023 dhe 12,765 mijë Lekë më 31 Dhjetor 2022.

Drejtuesit nuk na kanë vendosur në dispozicion evidencën e përshtatshme për auditimin në lidhje me këto shuma. Përlogaritjet tona të pavarura tregojnë një mbivlerësim material të rzerervave teknike neto pas aktiveve përkatëse të risigurimit në një interval midis shumave 193,099 mijë Lekë dhe 223,767 mijë Lekë më 31 dhjetor 2023. Duke qenë se pjesa më e madhe e rezervave është regjistruar përpara vitit 2023, rezervat teknike të sigurimit neto pas aktiveve të risigurimit më 31 dhjetor 2022 dhe fitimi i pashpërndarë më 1 janar 2022 mund jenë gjithashtu të mbivlerësuar në vlerë materiale. Megjithatë, në mungesë të evidencës së përshtatshme të auditimit për IBNR dhe pjesës së risiguruesit më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022, nuk ishte e mundur të përcaktohej shuma e saktë e korigjimit të rezervave teknike të sigurimit dhe aktiveve të risigurimit në datat përkatëse, si dhe efekti përkatës në ndryshimin e rezervave bruto të dëmeve të sigurimit, ndryshimi përkatës në pjesën e risiguruesit dhe shpenzimet e tatimit mbi fitimin.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë me rezervë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK") dhe Kodin e Etikës për Audituesit Ligjorë që është i rëndësishëm në auditimin tonë të pasqyrave financiare në Shqipëri. Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së dhe Kodin e Etikës për Audituesit Ligjorë.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
Rruga Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Përgjegjësitë e drejtuesve dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtuesit janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare sipas politikave kontabël të përshkruara në shënimin shpjegues 2 të pasqyrave financiare, për të përcaktuar se baza e përgatitjes është e përshtatshme sipas rrethanave përkatëse dhe për kontrollet e brendshme, të cilat ata i gjykojnë të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtuesit janë përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vendosur në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtuesit synojnë që Shoqëria të likuidohet apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç këtyre.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por ajo nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomali mund të vijë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticism profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose shmangie të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo me qëllim që të shprehim një opinion mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe të shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtuesit.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtuesit dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të përfshijmë një rezervë në opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Auditues Ligjor

Jonid Lamllari



PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.

2 korrik 2024

Tiranë, Shqipëri



Sigma Vienna Insurance Group SH.A.
Pasqyra e pozicionit financiar – 31 dhjetor 2023

Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2023	31 dhjetor 2022
AKTIVET			
Aktive afatgjata materiale	8	284,053	303,017
Aktive afatgjata jo-materiale	9	41,888	48,083
Pasuri e investuar	10	51,025	51,025
Aktive me të drejtë përdorimi	11	200,359	267,453
Investime në sipërmarrje të përbashkëta	12	26,689	26,689
Aktive të risigurimit	13	3,645,495	2,234,385
Investime në letra me vlerë të mbajtura me kosto të amortizuar	14	3,372,505	3,264,535
Tatim fitimi i arkëtueshëm		16,056	-
Depozita me afat	15	2,264,684	2,169,345
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	16	363,224	340,828
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	17	188,404	375,445
Aktive të tjera	18	117,128	156,507
Mjete monetare, ekuivalentë të tyre dhe kufizimet përkatëse	19	272,288	381,984
TOTALI I AKTIVEVE		10,843,798	9,619,296
KAPITALI			
Kapitali aksionar	20	498,213	498,213
Rezerva e rrezikut të sigurimit	21	594,192	594,192
Rezerva e rivlerësimit	21	48,773	52,751
Rezerva e përthithjes	21	308,207	333,207
Rezerva e përthimit		(160,054)	(91,779)
Fitimi i pashpërndarë		590,386	559,253
TOTALI I KAPITALIT		1,879,717	1,945,837
DETYRIMET			
Rezerva teknike të sigurimit	22	5,356,520	3,787,246
Rezerva për primin e pafituar	27	1,781,729	1,797,824
Detyrime tatimore të shtyra	36	4,398	5,100
Detyrime tatimore dhe të tjera	23	35,518	31,992
Tatim fitimi për t'u paguar		5,705	8,578
Detyrime të qirasë	11	210,036	277,212
Depozita e risiguruesit	24	1,257,836	1,297,425
Detyrime nga veprimtaria e sigurimit dhe të tjera	25	312,340	468,082
TOTALI I DETYRIMEVE		8,964,081	7,673,459
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		10,843,798	9,619,296

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Këshilli i Mbikëqyrës së Shoqërisë më datë 26 qershor 2024 dhe nënshkruar në emër të tij nga:

Klaidi Çitozi
Drejtor i Përgjithshëm

Ilir Elmazi
Drejtor i Financës – VIG Services SH.P.K.



Shënimet në faqet 5 deri në 39 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Sigma Vienna Insurance Group SH.A.**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	2023	2022
Prime të shkruara bruto	26	3,940,949	3,949,261
Ndryshimi në rezervën e primeve të pafituara bruto	27	(37,542)	(98,727)
Te ardhura nga primet e sigurimit		3,903,407	3,850,534
Prime të shkruara ceduar risiguruesit	28	(1,733,509)	(1,788,505)
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit për primet e pafituara	28	(38,213)	66,872
Prime të shkruara neto ceduar risiguruesit		(1,771,722)	(1,721,633)
Prime të fituara neto		2,131,685	2,128,901
Komisionet e risigurimit	29	657,562	712,055
Të ardhura nga investimet	30	182,694	168,602
Të ardhura të tjera		15,115	19,533
Të ardhura neto		2,987,056	3,029,091
Dëme të paguara bruto	22	(1,713,617)	(1,965,655)
Dëme të paguara nga risiguruesi	22	687,102	937,375
Ndryshimi në rezervat teknike për dëme,bruto	22	(1,763,671)	131,629
Ndryshimi në pjesën e risiguruesit në rezervat teknike për dëme	22	1,623,696	(330,805)
Shpenzime për dëme neto		(1,166,490)	(1,227,456)
Shpenzime të marrjes në sigurim	31	(698,085)	(725,204)
Shpenzime administrative	32	(661,491)	(622,354)
Shpenzime të tjera të veprimtarisë së sigurimit	33	(44,604)	(42,684)
Shpenzime		(1,404,180)	(1,390,242)
(Humbje)/fitim nga kursi i këmbimit, neto	34	(27,658)	8,012
Shpenzime financiare	35	(44,964)	(28,470)
Fitimi para tatimit		343,764	390,935
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	36	(53,459)	(61,839)
Fitim i vitit		290,305	329,096
Zërat që mund të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje:			
Përkthimi i një njësie të huaj në monedhën raportuese		(68,275)	(46,375)
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		222,030	282,721

Shënimet në faqet 5 deri 39 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Sigma Vienna Insurance Group SH.A.
Pasqyra e ndryshimeve në kapital

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva për veprimtarinë e sigurimit	Rezerva e përthithjes	Rezerva e rivlerësimit	Rezerva e përkthimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 1 janar 2022	498,213	594,192	333,207	56,727	(45,400)	558,019	1,994,958
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	329,096	329,096
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	-	-	-	-	(46,379)		(46,379)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	-	(46,379)	329,096	282,725
Tepricë rivlerësimi e transferuar në fitimin e pashpërndarë	-	-	-	(3,979)	-	3,979	-
Dividend i paguar(shënimi 20)	-	-	-	-	-	(331,838)	(331,838)
Gjendja më 31 dhjetor 2022	498,213	594,192	333,207	52,751	(91,779)	559,253	1,945,837
Gjendja më 1 janar 2023	498,213	594,192	333,207	52,751	(91,779)	559,253	1,945,837
Fitimi i vitit	-	-	-	-	-	290,305	290,305
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi	-	-	-	-	(68,275)		(68,275)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	-	(68,275)	290,305	222,030
Tepricë rivlerësimi e transferuar në fitimin e pashpërndarë	-	-	-	(3,977)	-	3,977	-
Dividend i paguar(shënimi 20)	-	-	(25,000)	-	-	(263,150)	(288,150)
Gjendja më 31 dhjetor 2023	498,213	594,192	308,207	48,773	(160,054)	590,385	1,879,717

Shënimet në faqet 5 deri 39 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Sigma Vienna Insurance Group SH.A.**Pasqyra e flukseve monetare***(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)*

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022
Fitimi para tatimit		343,764	390,935
Flukset monetare nga veprimtaria shfrytëzuese			
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	8,9,11	101,387	102,421
Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale		370	
Humbje nga çvlerësimi i llogarive të arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit		2,223	742
Shpenzime interesi		44,962	27,469
Të ardhura nga investimet		(182,693)	(167,174)
Flukset monetare nga veprimtaritë shfrytëzuese përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet e veprimtarisë shfrytëzuese		310,013	354,393
Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit		184,819	(133,021)
Aktive të tjera		39,379	(12,787)
Aktive të risigurimit		(1,411,110)	280,866
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim		(22,396)	34,922
Rezerva teknike të sigurimit		1,569,274	(163,521)
Rezerva për primin e pafitur		(16,095)	31,004
Depozitat e risigurimit		(39,589)	41,519
Detyrime nga veprimtaria e sigurimit dhe detyrime të tjera		(155,742)	(10,073)
Detyrime tatimore dhe të tjera		3,526	107,144
Mjete monetare të kufizuara		1,810	-
Flukset monetare nga veprimtaritë shfrytëzuese përpara interesave dhe tatimit		463,889	530,446
Interesa të marra		157,788	161,048
Interes i paguar		(44,962)	(27,469)
Tatim fitimi i paguar		(72,387)	(49,419)
Flukset monetare nga veprimtaritë shfrytëzuese neto		504,328	614,606
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë investuese			
Blerje e aktiveve jo-materiale	9	(11,073)	(8,740)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8	(16,780)	(28,869)
Investime të mbajtura me kosto të amortizuar		(278,104)	(317,623)
Maturime të investimeve me kosto të amortizuar		47,000	364,000
Shtesa në depozitat me afat		(95,339)	(162,827)
Investim në kapitalin e pjesëmarrjes së përbashkët		-	(6,146)
Flukse monetare të përdorura në veprimtaritë investuese neto		(354,296)	(160,205)
Flukset monetare të përdorura në veprimtaritë financuese			
Pagesa të qirasë	11	(61,135)	(65,473)
Dividend i paguar	20	(288,149)	(314,160)
Flukset monetare të përdorura në veprimtaritë financuese neto		(349,284)	(379,633)
(Rritje)/ulje neto në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre		(199,252)	74,768
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fillim të vitit		377,322	310,905
Efekti i përkthimit		91,266	(8,351)
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre në fund të vitit	19	269,436	377,322

Shënimet në faqet 5 deri 39 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Këto pasqyra financiare janë përgatitur nga Sigma Vienna Insurance Group SH.A. ("Shoqëria" ose "SIVIG") në përputhje me kërkesat e Ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

Shoqëria është themeluar në 1999 dhe regjistruar në Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.20487 me datë 3 shkurt 1999. Më 30 shtator 2014, emri i Shoqërisë ndryshoi në Sigma Interbalkanian Vienna Insurance Group SH.A. pas bashkimit me përthithje me Interbalkanian SH.A., degë e Vienna Insurance Group.

Shoqëria mëmë e Shoqërisë është Vienna Insurance Group Ag Wiener Versicherung Gruppe, Vjenë, Austri ("Grupi"), e cila zotëron 89.05% të aksioneve. Njësia ekonomike kontrolluese është Wiener Städtische Wechselseitiger Versicherungsverein - Vermögensverwaltung - Vienna Insurance Group, Vjenë, Austri.

Veprimtaria kryesore: Aktiviteti kryesor i Shoqërisë përfshijnë ofrimin e shërbimeve të sigurimit për automjetet motorike, pasurinë, shëndetin dhe lloje të tjera të sigurimit të produkteve të jo-jetës në Shqipëri dhe Kosovë. Aktiviteti në Kosovë menaxhohet nga Shoqëria në Shqipëri.

Aktiviteti i Shoqërisë në Shqipëri është subjekt i ligjit nr. 9901 datë 14 prill 2008 "Mbi sipërmarrësit dhe shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimi" ("akti i sigurimit"). Rregullatori i tregut të sigurimeve në Shqipëri është Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare (në vijim "Autoriteti" ose "AMF").

Dega është themeluar më 11 tetor 2004 dhe operon me licencë të lëshuar nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për të siguruar sigurimin e përgjithshëm të rrezikut të jo-jetës në Republikën e Kosovës sipas dispozitave të Ligjit të Sigurimeve të Kosovës, Ligji nr. 05/L045 "Për Sigurimet".

Adresa e zyrtare e regjistruar: Zyrtar qendrore të Shoqërisë gjenden në Rr. Komuna e Parisit, Pallatet Lura, Kati i dytë, Tiranë, Shqipëri. Adresa e filialit është në Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27, Prishtinë, 10000, Republika e Kosovës.

Shoqëria kishte 295 punonjës më 31 dhjetor 2023 (2022: 299).

Këshilli mbikëqyrës dhe Bordi Menaxhues gjatë vitit 2023 dhe deri në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare është i përbërë nga:

Bordi Mbikëqyrës	Pozicioni	Bordi Drejtues	Pozicioni
Z. Peter Hoefinger	Kryetar	Z. Klaidi Citozi	Drejtor i Përgjithshëm
Z. Christoph Rath	Anëtar	Z. Artan Pjetërnika	Anëtar Bordi
Z. Jonard Prodani	Anëtar	Z. Ervin Rali	Anëtar Bordi
Znj. Liane Hirner	Anëtar		
Znj. Sonja Raus	Anëtar		

2. Bazat e përgatitjes

Monedha funksionale dhe e përgatitjes Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek shqiptar (ALL), që është monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha kryesore e mejdosit ekonomik në të cilin Shoqërisë kryen veprimtarinë e saj. Të gjitha shumat janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt. Monedha funksionale e aktiviteve të saj të në Kosovë është Euro ("EUR").

Bazat e matjes. Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim të pasurisë së investuar dhe ndërtesave (të klasifikuara si aktive afatgjata) që maten me vlerë të drejtë.

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, përveçse kur deklarohet ndryshe.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimi Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon përdorimin e çmuarjeve kyçe kontabël. Gjithashtu kërkon që drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël së Shoqërisë. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në çdo periudhë të ardhshme që preket. Drejtimi gjykon se supozimet bazë janë të përshtatshme dhe si rrjedhojë pasqyrat financiare paraqesin pozicionin financiar dhe rezultatet në mënyrë të drejtë.

Fushat që përfshijnë një shkallë më të lartë gjykimi, ose fushat ku janë të rëndësishme për supozimet dhe vlerësimet e pasqyrave financiare janë shpalosur në shënimin 3.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Vijueshmëria Drejtimi i Shoqërisë ka vlerësuar aftësinë për të vazhduar aktivitetin në vijimësi dhe është i kënaqur që ka burime për të vazhduar biznesin për të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, drejtimi nuk është në dijeni për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedhë dyshime të rëndësishme mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Pasqyrat financiare përgatiten mbi bazën e vijueshmërisë.

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar nga Shoqëria, përveç rasteve kur është shprehur ndryshe.

(a) Investimet në sipërmarrje të përbashkëta

Investimet në sipërmarrje të përbashkëta Investime të tilla klasifikohen si operacione të përbashkëta ose pjesëmarrje të përbashkëta, në varësi të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të secilit investitor. Shoqëria ka vlerësuar natyrën e marrëveshjes së saj të përbashkët me Intersig Vienna Insurance Group SH.A. në VIG Services SH.P.K. dhe e përcakton këtë investim si një sipërmarrje të përbashkët. Marrëveshja kontraktuale u siguron palëve të drejta mbi aktivet neto dhe jo mbi aktivet e saj, detyrimet e izoluar. Palët nuk kanë asnjë interes apo titull pronësie në aktivet e VIG Services. Më tej, të dy palët janë përgjegjëse vetëm për masën e investimit të tyre në Shërbimet VIG dhe jo drejtpërdrejt për detyrimet e saj. Nisur nga forma ligjore, pronarët e Shërbimeve VIG nuk janë përgjegjës për detyrimet e saj (shoqëri me përgjegjësi të kufizuar). Pjesa e secilës palë në fitimet e Shërbimeve VIG është në përputhje me kuotën e tyre (e cila është 50% për secilën).

Sipërmarrjet e përbashkëta kontabilizohen nga Shoqëria në këto pasqyra financiare duke përdorur metodën e kostos.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja përkthehen në monedhën funksionale me kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Zërat jomonetarë në monedhë të huaj që maten në bazë të kostos historike përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Rezultatet dhe pozicioni financiar i operacioneve të huaja përkthehen në monedhën e prezantimit të këtyre pasqyrave financiare si më poshtë:

- i. aktivet dhe detyrimet për çdo pasqyrë të pozicionit financiar përkthehen me kursin e fundvitit në fund të periudhës përkatëse raportuese
- ii. të ardhurat dhe shpenzimet përkthehen me kursin mesatar të këmbimit (përveç rastit kur kjo mesatare nuk është një përafrim i arsyeshëm i efektit kumulativ të normave në datat e transaksionit, në të cilin të ardhurat dhe shpenzimet përkthehen me kursin mesatar në datat e transaksioneve);
- iii. të gjitha diferencat e kurseve të këmbimit njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe shtohen në rezervën e përkthimit në kapital dhe;
- iv. flukset monetare përkthehen me kursin mesatar të këmbimit të periudhës raportuese.

(c) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Produktet e Shoqërisë klasifikohen në fillim, për qëllime kontabël, si kontrata sigurimi. Një kontratë, e cila klasifikohet si kontratë sigurimi, mbetet si kontratë sigurimi derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet të shuhen ose të skadojnë.

Kontratat sipas të cilave Shoqëria pranon të marrë një rrezik sigurimi të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakort të kompensojë policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë për një ngjarje të caktuar të pasigurt (ngjarja sigurore) e cila ka efekte negative dhe ndikon në policë-mbajtësin apo përfituesit e tjerë, klasifikohet si kontratë sigurimi. Rreziku i sigurimit është i ndryshëm nga rreziku financiar.

Rreziku financiar është rreziku i një ndryshimi të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë nga një normë interesi të caktuar, çmimi i instrumentave financiarë, çmimi i mallit, kursi i këmbimit valutor, indeksi i çmimeve ose normat, një vlerësim kreditor ose indeksi kreditor ose ndryshore të tjerë, të parashikuar në rastin të një ndryshori jofinanciar që ai nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë gjithashtu një rrezik financiar.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Kontratat e sigurimit të përgjithshëm Detyrimet nga veprimtaria e sigurimit janë llogaritur në mënyrë të veçantë për të gjitha produktet e sigurimit dhe janë të përbëra nga primet e pafituara, rreziku i detyrimeve të ardhshme (të pa-skaduara) dhe humbjet lidhur me detyrimet e ardhshme (të papaguara në datën e mbylljes të vitit financiar). Detyrimet e veprimtarisë së sigurimit (provizionet) paraqesin vlerësime të pagesave të ardhshme për dëmet e raportuara dhe të paraportuara. Shoqëria nuk i aktualizon detyrimet e sigurimit. Çdo ndryshim në vlerësim është reflektuar në rezultatet e operacioneve në periudhën në të cilën vlerësimet janë ndryshuar. Vlerësimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që lidhet dhe kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe gjykimeve të posaçme. Shoqëria ka përdorur kërkesat e rregullatorëve ose strukturave mbikëqyrëse të sigurimit sipas territorit për të përcaktuar detyrimet e veprimtarisë së sigurimit.

Primet nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit Primet e shkruara bruto përbëjnë shumën e detyrimit gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin e drejtpërdrejtë pavarësisht faktit se këto shuma i përkasin plotësisht ose pjesërisht një periudhë kontabël të mëpasshme. Primet paraqiten pa përfshirë detyrimet e komisioneve ndaj agentëve/ndërmjetësve dhe përjashtojnë taksën e primit. Primet konsiderohen të fituar që nga data kur i bashkëlidhet rrezikut, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar.

Rezerva e primit të pafituar ("UPR") Rezerva e primit të pafituar në të gjitha linjat e biznesit përfshin atë pjesë të primeve të shkruara e cila vlerësohet se do të fitohet në vitin pasardhës, duke përdorur metodën proporcionale 1/365, e rregulluar në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Rezerva e primit të pafituar është ajo pjesë e primit e cila lidhet me periudha pas datës së raportimit. Primi i pafituar llogaritet nga primet e shkruara të cilat paraqiten bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj agentëve/ndërmjetësve dhe gjithashtu përjashtojnë taksën mbi primet. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim shtyhen veçmas si aktiv.

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë shpenzime që siguroesi kryen për të shitur, nënshkruar dhe nisur një kontratë të re sigurimi. Komisionet dhe shpenzimet e tjera (pagat e punonjësve të caktuar të përfshirë në funksionet e nënshkrimit dhe lëshimit të policave, si dhe tarifat mjekësore dhe të inspektimit) që lidhen kryesisht me kontratat e sigurimit të nënshkruara ose të rinovuara gjatë periudhës raportuese në të cilën janë kryer.

Shpenzimet konsiderohen si shpenzim i marrjes në sigurim dhe janë të kapitalizuara dhe njihen në fitim ose humbje në përpjesëtim me të ardhurat nga primet e shkruara. Për të lidhur shpenzimet e marrjes në sigurim me të ardhurat përkatëse nga primet e shkruara, ato shpërndahen sipas linjave të biznesit të kontratave të sigurimit në përputhje me mënyrën e blerjes, shërbimit dhe matjes së përfitimit të kontratave të sigurimit nga Shoqëria. Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim klasifikohen si aktive.

Dëmet që lidhen me veprimtarinë e përgjithshme të sigurimit Dëmet e ndodhura përfshijnë kostot e shlyerjes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që vijnë nga ngjarjet e siguruara të ndodhura gjatë vitit financiar së bashku me rregullimet në provizionin e dëmeve të vitit të kaluar. Shpenzimet e trajtimit të dëmeve përbëhen nga shpenzimet e jashtme të trajtimit të dëmeve të cilat nuk përfshijnë shpenzimet e brendshme të trajtimit të dëmeve të cilat konsiderohen si më pak të rëndësishme në krahasim me kostot e jashtme. Kërkesat e papaguara vlerësohen duke rishikuar pretendimet individuale dhe duke bërë kompensim për dëmet e ndodhura, por të pa raportuara ende, efektin e ngjarjeve të parashikueshme të brendshme dhe të jashtme, si ndryshimet në procedurat e trajtimit të dëmeve, inflacioni, tendencat gjyqësore, ndryshimet legjislative, përvoja e kaluar dhe tendencat.

Rregullimet për provizionin e dëmeve të viteve të mëparshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale

Pretendimet në lidhje me fondin e kompensimit për ngjarje të pasiguruara për dëmet e mjeteve motorike, të cilat i janë caktuar Shoqërisë nga AMF-ja dhe Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS). Pala e siguruar e përfshirë në një aksident automobilistik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nga një mjet i pasiguar ose i paidentifikuar, kanë të drejtën e dëmshpërblimit nga BSHS, konkretisht nga Fondi i Kompensimit. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të kontribuojnë financiarisht në fondin e kompensimit çdo vit në raport të drejtë me primet e shkruara bruto në këto lloje sigurimesh dhe gjithashtu të trajtojnë dëmet e shpërndara nga BSHS. Shoqëria vlerëson provizionet për këto pretendime bazuar në përvojën e saj historike si dhe në pritshmëritë e ardhshme.

Të gjitha shoqëritë e sigurimit të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës për të sigurimin e produkteve të MTPL në Kosovë, Byroja Kosovare e Sigurimeve ("KIB") administron sistemin për shitjen e policave për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike ndaj palës së tretë ("MTPL") në kufirin e Republika e Kosovës shoferët e mjeteve motorike të huaja të regjistruara që nuk kanë njëp sigurim të tillë. KIB ia kthen pjesën mujore të primeve bruto të shkruara (përfshirë TVSH-në dhe tatimin mbi primin e shitur, të cilat më pas përfshihen në deklaratat tatimore të vetë kompanive të sigurimit), për secilën shoqëri sigurimit.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Çdo shoqëri sigurimi kërkohet të kontribuojë në një përqindje të caktuar në primet bruto të shkruara (neto nga tatimet) për dëmet dhe shpenzimet e tjera administrative të shoqërisë dhe aktivitetet e anëtarësimit të KIB. Trajtimi kontabël i primeve të shkruara dhe rezervave të sigurimit të përcaktuara nga KIB, është i njëjtë me trajtimin e kategorive të tjera të primeve të shkruara dhe rezervave të sigurimit.

Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të kontribuojnë financiarisht për Fondin e Kompensimit të Kosovës (KIB), i cili përdoret për të paguar dëmet e sigurimit në lidhje me aksidentet e shkaktuara nga automjete të pasiguruara, të panjohura ose ngjarje të tjera të specifikuara. Shoqëritë e sigurimit janë të detyruara të kontribuojnë financiarisht në fondin e kompensimit çdo vit dhe gjithashtu të trajtojnë dëmet e shpërndara nga BQK-ja. Rezervat e dëmeve nga KIB janë pjesë e detyrimeve të kontratës së sigurimit të aktivitetit të Kosovës. Kontributi për fondin e kompensimit njihet në fitim ose humbje.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve Shoqëria kryen teste të mjaftueshmërisë së detyrimeve për të siguruar përshtatshmërinë e rezervave të dëmeve dhe rezervave të primeve të pafituara. Analiza 'Run-off' përdoret për të rishikuar rezervat e dëmeve. Në rast se analiza tregon mospërputhje të mëdha (rezultat negativ) pa shpjegimin e duhur, bëhen rregullimet e duhura në metodologjinë e rezervimit. Një test shtesë i mjaftueshmërisë së detyrimit i kryer për primin e pafituar që përfaqëson llogaritjen e rezervës së rrezikut të paskaduar (URR).

Kjo rezervë llogaritet në baza tremujore nga subjekti raportues. Ndryshori kryesor i përdorur në këtë rast është raporti i kombinuar (raporti i shumës së dëmit dhe shpenzimeve). Nëse vlera e raportit të kombinuar është nën 100%, UPR mund të konsiderohet si adekuate. Në rast se raporti i kombinuar është më i madh se 100%, atëherë URR bëhet për te plotësuar mungesën e UPR.

Risigurimi Shoqëria cedon primet e siguruara dhe rrezikun duke zvogëluar kështu potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linja e biznesit MTPL dhe aksidenteve përfshirë këtu dhe kartonin jeshil, sigurimin e pasurisë, marinës dhe aviacionit, detyrime civile dhe të tjera dhe linja të tjera biznesi. Risigurime të tilla përfshijnë marrëveshje të tejkallimit të humbjeve dhe marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjesë të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe kohës regjistrohen si aktive risigurimi. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë Shoqërinë nga detyrimet e drejtpërdrejta ndaj policëmbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur afati i tyre mbaron. Primet e siguruara ose primet e ceduara tek risiguruesit njihen si shpenzime në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit.

Për aktivitetin e përgjithshëm të sigurimit, primet e risigurimit njihen si shpenzime në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi. Shuma e njohur si aktive të risigurimit matet në mënyrë konsistente me matjet e provizionit të mbajtur për kontratat lidhura të sigurimit. Shumat e njohura si aktive risigurimi maten mbi një bazë që është në përputhje me matjen e provizionit të mbajtur në lidhje me kontratat përkatëse të sigurimit.

Aktivitet nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit në lidhje me primet e ceduara tek risiguruesit dhe arkëtimet nga shoqëria risiguruese në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si aktive nga risigurimi dhe paraqiten të veçanta, nëse ka. Aktivitet nga risigurimi vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka tregues si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Shoqëria mund të mos arkëtojë të gjitha shumat dhe ngjarja ka një ndikim të matshëm në shumat që Shoqëria do të marrë.

Rezerva e primit për portofolin e risiguruesit Kur një risigurues i ri merr pjesë në një kontratë në vitin financiar ose kur përfshirja në një periudhë të një risiguruesi ekzistues pjesëmarrës rritet, primi i pafituar i marrë llogaritet nga risiguruesi për pjesëmarrje në rreziqe për të cilat primi është mbledhur, por i pa fituar. Hyrja në portofolin e primeve në fillim të periudhës së risigurimit është përqindja e pjesës së risiguruesit për primin e pafituar në fillim të periudhës.

Depozita dhe detyrimet e risigurimit. Shoqëria ka një marrëveshje me VIG AG në mënyrë që detyrimet e papaguara nga Shoqëria të depozitohen në një bankë tregtare vendase në Shqipëri me një vlerësim të duhur kreditor dhe të jenë detyrime ndaj VIG AG. Shoqëria paguan një interes përfaqësues të vlerës së parasë për vitin. Shuma mund të përdoret nga Shoqëria për të shlyer dëmet e papaguara ose të ardhshme të shkaktuara që kualifikohen për rikuperim nga risigurimi nga VIG AG. Detyrimet e tjera ndaj risiguruesve të tjerë për primet e ceduara paraqiten si detyrime të tjera sigurimi dhe nuk kompensohen nga aktivet e risigurimit.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit. Përfshijnë shumat e detyrimeve nga klientët për primet e shkruara dhe fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke i zbritur humbjet nga çvlerësimi. Ato përfshijnë gjithashtu mjete monetare të gatshme të mbajtura nga agjentët për prime të shkruara. Llogaritë e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit shqyrtohen për çvlerësim në çdo datë raportimi.

Duke qenë se shumat nuk janë të rëndësishme individualisht ato grupohen në bazë të ditëve të vonuara dhe secila kategori aplikohet me një raport humbjeje nga çvlerësimi që bazohet në përvojën e mëparshme të Shoqërisë. Skema e provizionimit e përdorur nga Shoqëria është si më poshtë:

Ditë në vonesë	Klasifikimi	Raporti i humbjes
0-90	Rjedhëse	0%
91-180	Në vonesë	25%
181-365	Në vonesë të konsiderueshme	50%
365+	Të çvlerësuar	100%

(d) Aktive afatgjata materiale

Prona dhe pajisjet, përveç ndërtesave, maten me kosto duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Kostoja përfshin shpenzimet që i takojnë drejtpërdrejt koston së blerjes së aktivitetit. Humbjet dhe fitimet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një elementi të pajisjeve përcaktohen përmes krahasimit të të ardhurave të gjeneruara nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën e mbetur të pajisjes, dhe njihen neto brenda të ardhurave të tjera në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Ndërtesat mbahen në shumën e rivlerësuar dhe i nënshtrohen rivlerësimit rregullisht në mënyrë që vlera kontabël të mos ndryshojë materialisht nga ajo që do të përcaktohej duke përdorur vlerën e drejtë në fund të periudhës raportuese. Rritjet në vlerën kontabël që rrjedhin nga rivlerësimi kreditohen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe rrisin tepicën e rivlerësimit në kapital. Zbritjet që kompensojnë rritjet e mëparshme të të njëjtit aktiv njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe ulin tepicën e rivlerësimit të njohur më parë në kapital; të gjitha zbritjet e tjera ngarkohen në fitim ose humbje për vitin.

Rezerva e rivlerësimit për ndërtesat përfshihet në kapital dhe transferohet drejtpërdrejt në fitimet e pasqyrës, kur aktivi përdoret; shuma e tepicës së realizuar është diferenca midis zhvlerësimit të bazuar në vlerën kontabël të rivlerësuar të aktivitetit dhe amortizimit bazuar në koston fillestare të aktivitetit duke i zbritur pjesën e tatimit mbi të ardhurat e shtyra të njohur në fillim.

Kosto e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbetur të elementit nëse pritet që prej këtij zëvendësimi të rrjedhin përfitime të ardhshme ekonomike për shoqërinë dhe nëse kjo kosto mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të riparimit të aktiveve njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ato ndodhin.

Toka nuk zhvlerësohet. Zhvlerësimi i aktiveve të tjera llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur përgjatë jetëgjatësisë si më poshtë:

Ndërtesa dhe përmirësimet e qirasë	20 vite
Mjete motorike	5 vite
Pajisje kompjuterike dhe zyre	5 vite

Shoqëria nuk ka vlerësuar ndonjë vlerë të mbetur për pronën dhe pajisjet e saj pasi i vlerëson ato si jo të domethënëse.

Përmirësimet e qirasë kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës më të vogël të jetës së tyre të dobishme dhe afatit të qirasë.

Metodat e zhvlerësimit dhe jetëgjatësia e dobishme rivlerësohen dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në çdo datë raportimi.

Aktive me të drejtë përdorimi

Shoqëria merr me qira ambientet e zyrave. Nëse kontratat përmbajnë komponentë të qirasë dhe jo-qirasë, për qiradhëniet e pasurive të paluajtshme për të cilat Shoqëria është qiramarrëse, ajo ka zgjedhur të mos ndajë komponentët e qirasë dhe jo-qirasë por i llogarit këto si një komponent të vetëm të qirasë. Aktivet që rrjedhin nga qiraja fillimisht maten në bazë të vlerës aktuale.

Aktivitet me të drejtë përdorimi në përgjithësi amortizohen gjatë periudhës më të shkurtër mes të jetës së dobishme të aktivitetit dhe afatit të qirasë në bazë lineare. Amortizimi i zërave të aktiveve me të drejtë përdorimi llogaritet duke përdorur metodën lineare gjatë jetëgjatësisë së tyre të dobishme të parashikuar të ndërtesave prej 3 vitesh.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**(e) Aktive jomateriale**

Aktivet jo-materiale të Shoqërisë përfshijnë programet kompjuterike të kapitalizuar. Programi kompjuterik i blerë kapitalizohet në bazë të kostove të bëra për blerjen dhe vënien në përdorim të tyre. Aktivet jo-materiale amortizohen duke përdorur metodën e vlerës së mbetur gjatë jetës së tyre të dobishme prej 4 vitesh.

(f) Pasuri e investuar

Pasuritë e investuara janë prona të mbajtura nga Shoqëria për të fituar të ardhura nga qiraja ose për rritjen e kapitalit, ose për të dyja, dhe nuk janë të përdorura nga Shoqëria.

Pasuritë e investuara fillimisht njihen me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe më pas rimaten me vlerën e drejtë të përditësuar për të pasqyruar çmimet e tregut në fund të periudhës raportuese. Vlera e drejtë e pronës së investuar është çmimi që do të merret nga shitja e saj në një transaksion të rregullt, pa zbritur kostot e transaksionit. Treguesi më i mirë e vlerës së drejtë merret nga çmimet aktuale në një treg aktiv për prona të ngjashme në të njëjtin vendodhje. Në mungesë të çmimeve aktuale në një treg aktiv, Shoqëria merr në konsideratë informacionin nga një sërë burimesh, duke përfshirë çmimet e fundit të pronave të ngjashme në tregje më pak aktive, me rregullime për të pasqyruar çdo ndryshim në kushtet ekonomike që nga data e transaksioneve që kanë ndodhur me ato çmime.

Vlera e tregut e pasurisë së investuar të subjektit raportues përcaktohet në bazë të raporteve të vlerësuesit të pavarur "Silva Studio SH.P.K", me numër license 0040/1, të cilët kanë kualifikime profesionale të njohura dhe përkatëse dhe që kanë përvojë të kohëve të fundit në vlerësimin e pronës në të njëjtin vend dhe kategori. Vlerësimi është kryer më 29 dhjetor 2023. Metoda e përdorur nga vlerësuesit e pavarur "Silva Studio SH.P.K." është metoda e krahasimit të drejtpërdrejtë.

Të ardhurat e fituara nga qiraja njihen në fitim ose humbje të vitit si pjesë përbërëse e të ardhurave nga investimi. Fitimet dhe humbjet që vijnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë të aktivit afatgjatë material të investuar regjistrohen në fitim ose humbje për vitin dhe paraqiten veçmas

(g) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Në çdo fund të çdo periudhe raportuese, drejtimi vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të aktiveve afatgjata materiale. Asnjë tregues i tillë nuk u identifikua në datën e raportimit.

(i) Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të Shoqërisë (aktivet dhe detyrimet) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë duke i shtuar kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare evidentohet nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje nga njohja fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit, i cili mund të evidentohet nga transaksione të tjera aktuale të vëzhgueshme të tregut në të njëjtin instrument ose nga një teknikë vlerësimi, inputet e së cilës përfshijnë vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme.

Aktivet financiare e Shoqërisë janë klasifikohen si depozita me afat me bankat dhe llogari të arkëtueshme. Llogarite e arkëtueshme nga veprimtaria e sigurimit janë aktive të sigurimit. Letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria Shqiptare nuk klasifikohen si të mbajtura deri në maturim pasi nuk ka treg aktiv për këto letra dhe për rrjedhojë ato përmbushin përkufizimin e huave dhe llogarive të arkëtueshmeve. Detyrimet financiare klasifikohen si detyrime të tjera financiare (përfshirë detyrimet nga veprimtaria e sigurimit dhe detyrimet të tjera) dhe llogariten kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj sipas kontratës dhe mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv/përdorur metodën e interesit efektiv.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme të sigurimit janë aktive financiare jo-derivative të pakuotuar me pagesa fikse ose të ndryshme nga ato që Shoqëria synon të shesë në periudhën e afërt. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme përfshijnë depozitat me afat pranë bankave, llogaritë e tjera të arkëtueshme, bonot dhe obligacionet e thesarit të emetuara nga Qeveria Shqiptare mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke i zbritur provizionin për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

Çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur aktivet riblihen. Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

Matja e Kostos së amortizuar. Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar njihet në njohjen fillestare minus çdo ripagim të kryegjësë, plus interesin e përlllogaritur, dhe për aktivet financiare minus çdo zhvlerësim për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi. Interesi i përlllogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose aktualizimi deri në maturim duke përdorur metodën e interesit efektiv.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

